



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	29.04.2022
REFERENCË:	01-030/03-0039624
PËR/ZA/TO:	znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njesisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri Hamza – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Elvis Feka – Kryetar i Komisioni për hartimin e Draft-Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallja e diskutimit publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për vetëqeverisje lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës; nenin 3 paragrafi 5, nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1.3, të UA Nr. 06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

Për Draft-Rregulloren për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në debatin publik, i cili do të mbahet ditën e **enjte**, me datë **12.05.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora **10:00**.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e Draft-Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e domosdoshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com ose drejtpërdrejt të grupi punues i rregullores përmes kryetarit të grupit punues z.Elvis Feka (e-mail: elvis.feka@rks-gov.net).

Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale të miratuar nga Grupi punues për hartimin e Draft-Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, i formuar me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.